



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 3489/7 prot.

Pogradec, më 18.09, 2025

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

Zj. Manjola Kamolli
KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

E nderuara zonja Kryetare,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt vendimin, dhe relacionin shoqërues, për miratimin e Rregullores “Për kriteret, procedurat e dhënies së titujve të nderit si dhe vendosjes së emërtesave të rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Pogradec”

Me respekt,

KRYETARI

Ilir XHAKOLLI



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 2 (dy)

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 2 (dy)

Nr. i faqeve A4 të rregullores 8 (tetë)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA POGRADEC

KËSHILLI

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më ____ . ____ . 2025

PROJEKT-VENDIM

NR. _____, DATË ____ . ____ . 2025

“ PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KRITERET , PROCEDURAT E DHËNIES SË TITUJVE TË NDERIT SI DHE VENDOSJES SË EMËRTESAVE TË RRUGËVE, SHESHEVE, TERRITOREVE, INSTITUCIONEVE DHE OBJEKTEVE NË JURIDIKSIONIN E BASHKISË POGRADEC”

Në mbështetje të nenit 113/1 shkronja “dh”, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “b” dhe nënpika 1.7 shkronja “a”, dhe “b”, nenit 54 shkronja “ll” dhe shkronja “m”, dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit Nr. 93/2022 “Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 94/2022 “Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, nenit 3 të ligjit nr. 9270, datë 29.07.2004 “Për sistemin e adresave”, të ndryshuar, VKM nr 861 datë 10.02.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënie të Medaljeve dhe Titujt Vendorë të Nderit në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,


KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I:

1. Miratimin e Rregullores “Për kriteret, procedurat e dhënies së titujve të nderit si dhe vendosjes së emërtesave të rrugëve, shesheve , territoreve , institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Pogradec “, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Komisioni Këshillimor për dhënie të Titujve Vendor të Nderit në Bashkinë Pogradec.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

**KRYETAR
MANJOLA KAMOLLI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE DHE PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. 348/Prof
7

Pogradec, më 18.09.2025

RELACION
MBI PROJEKT-VENDIMIN

“PËR

“ MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KRITERET, PROCEDURAT E DHËNIES SË TITUJVE TË NDERIT SI DHE VENDOSJES SË EMËRTESAVE TË RRUGËVE, SHESHEVE, TERRITOREVE, INSTITUCIONEVE DHE OBJEKTEVE NË JURIDIKSIONIN E BASHKISË POGRADEC”,

Argumentimi ligjor mbi natyrën e aktit administrativ:

Aktet administrative sipas natyrës së aktit ndahen në:

- 1) Akte administrative me karakter normativ
- 2) Akte administrative me karakter individual
- 3) Akte administrative me karakter kolektiv

Sipas përcaktimit të nenit 13 pika 2 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, “Vendimet, urdhrat dhe urdhëresat me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore i nënshtrohen verifikimit të ligjshmërisë nga autoriteti i përcaktuar me ligj.”

Po kështu, në ligjin 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, (i ndryshuar), neni 4, pika 1, përcakton: “Akte me karakter normativ” janë vendimet, urdhrat dhe urdhëresat e organeve të vetëqeverisjes vendore, përmes së cilës shprehet vullneti i këtyre organeve, në ushtrimin e funksionit të tyre publik, që i drejtohen subjekteve të papërcaktuara të së drejtës me qëllim përcaktimin e normave të përgjithshme të sjelljes dhe që i shtrijnë efektet në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njëhershme, brenda territorit të juridiksionit të organit të vetëqeverisjes vendore”.

Më tej, ky ligj në nenin 8 shkronja “a” përcakton se është përgjegjësi e Prefektit, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore.

Nga sa më sipër organet përgjegjëse pranë bashkisë kanë detyrimin e interpretimit të natyrës normative të aktit administrativ, procedurë e cila përcakton nëse akti administrativ që do të



miratohet në Këshillin Bashkiak do të verifikohet ose jo nga Prefekti i Qarkut Korçë për përputhshmëri ligjore.

Akti nënligjor normativ është një nga mënyrat se si autoritetet e pushtetit shtetëror, të ndryshme nga Kuvendi, rregullojnë me norma me karakter të përgjithshëm çështje të cilat ligji ua ka njohur atyre ushtrimin e pushtetit.

Bazuar në ligjin 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”, neni 3, pika 2 përcakton si vijon:

“Akti normativ nënligjor” është çdo shprehje e vullnetit nga një organ publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon një apo disa marrëdhënie juridike, duke vendosur rregulla të përgjithshme të sjelljes dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij”.

Neni 3 pika 1 shkronja “a” e Kodit të Procedures Administrative jep kete perkufizim për 1. “Akti administrativ”:

a) “Akti administrativ individual” është çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektsh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;

b) “Akti administrativ kolektiv” është një shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që i drejtohet një grupi subjektsh, anëtarët e të cilit janë të përcaktuar individualisht ose mund të përcaktohen individualisht mbi bazën e karakteristikave të përgjithshme, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete;

Akti normativ përcakton rregulla për një situatë abstrakte dhe që ju drejtohet një numri të pacaktuar subjektsh.

Në rastin e këtij Projekt - vendimi, gjykojmë se ai është një akt i cili plotëson elementet e përcaktuar në nenin 3, pika 2 të Ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”, pasi është një akt i nxjerrë nga një organ publik në ushtrim të funksionit të tij, i cili sjell rregulla të përgjithshme dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij si dhe me miratimin kësaj rregulloreje është një hap i rëndësishëm drejt modernizimit të administratës lokale dhe konsolidimit të një qasjeje të drejtë dhe transparente në çështjet e rëndësisë publike. Ky dokument është hartuar me kujdes për të siguruar një proces transparent, të drejtë dhe të unifikuar në dhënien e titujve të nderit dhe në emërtimin e hapësirave publike, duke pasur parasysh rëndësinë e ruajtjes së historisë, kulturës dhe vlerave të qytetit të Pogradecit. Kjo Rregullore jo vetëm që do të standardizojë procesin e dhënies së titujve të nderit dhe emërtimit të hapësirave publike, por gjithashtu do të kontribuojë në ruajtjen dhe promovimin e identitetit, historisë dhe vlerave të qytetit të Pogradecit.

Përfundimisht konkludojmë se: Akti administrativ është i natyrës normative dhe si i tillë kërkon verifikimin e përputhshmërisë ligjore nga Prefekti Qarkut Korçë, sipas ligjit.

Propozoi dhe interpretoi karakterin e aktit juridik: K.TANE 

KRYETAR

Ilir XHAKOLLI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

Pogradec, më ____ . ____ . 2025

RELACION

Në lidhje me Projekt-Vendimin për miratimin e Rregullores “Për kriteret, procedurat e dhënies së titujve të nderit si dhe vendosjes së emërtesave të rrugëve, shesheve , territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Pogradec “

E nderuar Kryetare e Këshillit !
Të nderuar Këshilltarë !

Projekt vendimi që po ju paraqesim është rrjedhojë e detyrimit ligjor që ka Institucioni i Bashkisë Pogradec, për të bërë të mundur dhënien e Titujve Vendorë të Nderit për personalitetet dhe figurat e shquara të Bashkisë Pogradec, të vendit dhe të huaj me kontribute të vecanta si dhe vendosjes së emërtesave të rrugëve, shesheve , territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Pogradec

Për këtë i propozojmë Këshillit Bashkiak miratimin e Rregullores “Për kriteret, procedurat e dhënies së titujve të nderit si dhe vendosjes së emërtesave të rrugëve, shesheve , territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Pogradec hartuar në mbështetje të nenit 113/1 shkronja “dh”, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “b” dhe nënpika 1.7 shkronja “a”, dhe “b”, nenit 54 shkronja “ll” dhe shkronja “m”, dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit Nr. 93/2022 “Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 94/2022 “Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, nenit 3 të ligjit nr. 9270, datë 29.07.2004 “Për sistemin e adresave”, të ndryshuar, VKM nr 861 datë 10.02.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e Medaljeve dhe Titujt Vendorë të Nderit në Republikën e Shqipërisë”

Ftojme Këshilltarët të votojnë këtë Projekt Vendim.

Faleminderit!

Konceptoi: Juriste Katerina Tane



Pranoi: Kryetare e Komisionit Këshillimor
Për dhënie të titujve të nderit

Entela Gushe



Miratoi: SEKRETARI PËRGJITHSHËM

Dritan Babasuli




Konfirmoi:

KRYETARI

Ilir XHAKOLLI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

RREGULLORE
PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E DHËNIES SË TITUJVE TË NDERIT SI DHE
VENDOSJES SË EMËRTESAVE TË RRUGËVE, SHESHEVE, TERRITOREVE,
INSTITUCIONEVE DHE OBJEKTEVE NË JURIDIKSIONIN E BASHKISË
POGRADEC

Neni 1
Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në mbështetje të nenit 113/1 shkronja “dh”, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “b” dhe nënpika 1.7 shkronja “a”, dhe “b”, nenit 54 shkronja “ll” dhe shkronja “m”, dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit Nr. 93/2022 “Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 94/2022 “Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, nenit 3 të ligjit nr. 9270, datë 29.07.2004 “Për sistemin e adresave”, të ndryshuar, VKM nr 861 datë 10.02.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e Medaljeve dhe Titujt Vendorë të Nderit në Republikën e Shqipërisë”,

Neni 2
Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim vendosjen e kritereve dhe procedurës që duhet ndjekur për përcaktimin e dhënien e titujve të nderit dhe për emërtimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Pogradec.

Neni 3
Parime të përgjithshme

1. Dhënia e titujve vendorë të nderit, udhëhiqet nga parimi i nderimit publik dhe i vlerësimit të kontributit ,transparencës dhe mirënjohjes publike
2. Përfitimi i një titulli nderi nuk është një e drejtë dhe nuk mund të kërkohej si e tillë, në rrugë individuale apo institucionale.
3. Personi që ka marrë një dekoratë nga Presidenti i Republikës nuk mund të përfitojë më vonë në kohë një titull nderi, medalje apo titull vendor nderi.
4. Dhënia e titullit vendor të nderit nuk shoqërohet me shpërblim financiar.

5. Rrugët, sheshet, territoret, institucionet dhe objektet në juridiksionin e Bashkisë Pogradec mund emërtohen me emra të personaliteteve të shquara në nivel kombëtar e lokal ose të huaja me kontribut në promovimin e interesave të Bashkisë Pogradec ose të Kombit Shqiptar si dhe ngjarje historike.

6. Personat dhe institucionet që marrin tituj duhet të jenë korrektë në perputhje me ligjin për pastërtinë e figurave.

Neni 4 **Subjektet përfituese**

1. Titujt e nderit u jepen shtetasve shqiptarë ose të huaj, të cilët kanë një kontribut të shquar në dobi të kombit shqiptar apo komunitetit të Bashkisë Pogradec, në fushat e ndryshme të jetës: historike, patriotike, kulturore- artistike, sportive, muzikore, humanitare, etj.
2. Nuk u jepen tituj vendor nderi personat që kanë qënë bashkëpunëtorë të ish Sigurimit të Shtetit.

Neni 5

Llojet e titujve vendor të nderit dhe përshkrimi i tyre

Titujt vendorë të nderit jepen nga Këshilli Bashkiak dhe Kryetari i Bashkisë respektivisht.

I . Këshilli Bashkiak jep këto tituj vendorë :

• Qytetar Nderi

1. Jepet për veprimtari të shquar , kontribute dhe merita të veçanta në shërbim dhe në dobi të Bashkisë ose për veprimtari për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të komunitetit brenda territorit të Bashkisë.
2. Personaliteteve të huaja të nivelit të lartë , që vizitojnë Bashkinë në kuadër të një vizite zyrtare ose shtetërore .

• Titull i veçantë vendorë i nderit

1. Këshilli i Bashkisë ka të drejtë të krijojë dhe të japë jo më shumë se 2 (dy) tituj të vecantë vendorë nderi në një vit kalendarik, për të shprehur mirënjohjen e posacme për veprimtarinë e shquar në dobi të komunitetit të saj.

2. Titujt e veçantë vendorë të nderit krijohen me vendim të njësisë së vetëqeverisjes vendore, i cili përmban:

- a) Nevojën për nderimin e veçantë;
- b) Arsyen përse nderimi me titullin "Qytetar Nderi", sipas pikës 9 të ligjit nr.94/2022, nuk është i përshtatshëm dhe i mjaftueshëm dhe shtetasi i propozuar për nderim duhet dalluar nga shtetasit e tjerë;
- c) Emërtesën e titullit të vecantë vendor të nderit, i cili përkon me një datë ose ngjarje të shënuar në territorin e njësisë së vetëqeverisjes vendore.

- **Krenaria e Qytetit**

1. Jepet nga Këshilli Bashkiak për kontribute në dobi të bashkësisë qytetare, që kanë lënë gjurmë në Bashkinë Pogradec , nderojnë qytetin dhe më gjërë

- **Mirënjohja e Qytetit**

1. Jepet nga Këshilli Bashkiak për kontribute në fushat e ndryshme të jetës: kulurore-artistike , historike , sportive, humanitare etje.

II. Kryetari i Bashkisë jep titujt :

- **Çelsi i Qytetit**

1. Personaliteteve të huaja dhe shqiptarë që vizitojnë zyrtarisht Bashkinë Pogradec.
2. Personaliteteve të larta të vendit , President , K/Ministër në rast të një vizite posacërisht në Bashkinë Pogradec.

- **E ardhmja e qytetit**

1. Ky titull u akordohet të gjithë të rinjve të shquar brënda dhe jashtë vendit në fusha të ndryshme. Nxënësve apo studentëve që mbarojnë me medalje të Artë shkollën e mesme dhe studimet e larta Universitare.

Neni 6

Autoriteti përgjegjës , e drejta e nismës dhe propozimit për dhënien e titujve të nderit.

Autoriteti përgjegjës për dhënien e titujve vendorë të nderit si dhe emërtesat e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Pogradec është Këshilli Bashkiak.

1.Propozimi për dhënien e titujve vendorë të nderit paraqiten nga :

- a) Kryetari i Bashkisë
- b) Çdo anëtar i Këshillit Bashkiak
- c) Prefekti i Qarkut

2.Propozimi për dhënien e emërtesave të rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Pogradec mund të bëhet nga :

- a) Çdo anëtar i Këshillit Bashkiak.
- b)Kryetari i Bashkisë.
- c) Prefekti i Qarkut
- d)Institucione shtetërore
- e)Komunitete/organizata/biznese

Neni 7

Kërkesa për ushtrimin e nismës ose propozimit për nderim

1. Organet e përcaktuara në Nenin 6 të kësaj Rregullore mund t'i ushtrojnë të drejtat e tyre të nismës dhe propozimit edhe duke u mbështetur në kërkesat eparaqitura nga

personat fizikë e juridikë, privatë ose publikë, për këtë qëllim, sipas parimeve dhe kritereve të Ligjit nr 94/2022.

2. Çdo person fizik e juridik, privat ose publik, ka të drejtë të paraqesë kërkesën për ushtrimin e së drejtës së nismës ose propozimit për një shtetas të caktuar në një nga institucionet që e ka këtë të drejtë sipas Nenit 6 të kësaj Rregullore. Në këtë rast kërkesa duhet të arsyetojë edhe shkaqet për të cilat kërkohet ushtrimi i së drejtës së nismës ose propozimit. Kërkesa nuk mund të paraqitet për nderimin e vetvetes.
3. Institucioni pranë të cilit është paraqitur kërkesa për ushtrimin e së drejtës së nismës ose propozimit, pas shqyrtimit të saj, vendos për pranimin ose refuzimin e kërkesës.

Neni 8

Kriteret për emërtimin e adresës

- 1- Çdo bulevard, rrugë, shesh, park ose institucion ka vetëm një emër të caktuar.
- 2- Nuk lejohet që në të njëjtin qytet ose fshat të Bashkisë Pogradec bulevardi, rrugë, shesh ose park me të njëjtin emër.
- 3- Bulevardet, rrugët, sheshet ose parqet mbajnë emrin e caktuar në të gjithë gjatësinë e tyre.
- 4- Lejohet emërtimi i bulevardeve, rrugëve, shesheve për persona, vetëm pas vdekjes, në këtë rast propozimi shqyrtohet pasi të jetë marrë dhe miratimi nga ana e familjarëve e të ndjerit
- 5- Nuk lejohet emërtimi i rrugëve, shesheve, bulevardeve, rrugicave, parqeve, institucioneve për persona që kanë qenë bashkëpunorë të ish-sigurimit të shtetit.

Neni 9

Procedura e propozimit dhe dokumentacioni shoqërues për emërtimet dhe adresat

- 1- Propozimi për emërtime dhe riemërtime duhet të bëhet në formë të kërkesës zyrtare nga subjektet që kanë të drejtën e propozimit sipas nenit 6 të kësaj rregulloreje duke iu drejtuar Këshillit Bashkiak Pogradec.
- 2- Kërkesa duhet të përmbajë vullnetin e komunitetit të caktuar të shprehur nëpërmes nënshkrimeve.
- 3- Kërkesa duhet të vijë e arsyetuar dhe të përmbajë CV apo historikun për individin apo ngjarje.

Neni 10

Propozimi për nderim dhe dokumentacioni shoqërues për titujt

1. Propozimi për nderim pranë institucionit përgjegjës për dhënien e titullit përkatës duhet të dërgohet jo më vonë se 90 ditë kalendarike përpara datës së propozuar për dhënien e titullit në sekretarinë e Këshillit Bashkiak, me përjashtim të rasteve të veçanta kur respektimi i këtij afati është bërë objektivisht i pamundur
2. Propozimi për nderim përmban:
 - a) institucionin propozues;
 - b) bazën ligjore për propozimin;
 - c) të dhëna identifikuese të shtetasit të propozuar për nderim;
 - ç) lidhjen ndërmjet institucionit dhe shtetasit të propozuar për nderim;
 - d) veprimtarinë e kryer nga shtetasi i propozuar për nderim, si dhe arsyet e hollësishme për nderimin e tij;
 - dh) llojin e titullit të propozuar;
 - e) informacione, shoqëruar me dokumentacionin provues, që vërtetojnë përmbushjen e kriterëve përkatës për nderim, sipas përcaktimeve të këtij Ligji 94/2022.
 - ë) informacionin se shtetasi i propozuar për nderim nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, si dhe nuk është nën hetim ose gjykim për një vepër penale nga organet përgjegjëse;
 - f) të dhënat për dekorime ose nderime të mëparshme të shtetasit të propozuar.
 - g) Materiale dokumentuese që dëshmojnë për arritjet e personalitetit gjatë jetës së tij, si certifikata, diploma, etj., të cilat ndihmojnë këshilltarët të kenë një informacion më të plotë të propozimit për dhënien e titullit apo çdo element tjetër të nevojshëm për verifikimin dhe plotësimin e kriterëve përkatës për nderim.
 - h) Miratimin/ dakortësinë e personit të propozuar.
 - i) Çdo propozim për dhënie titulli duhet të shoqërohet me motivacionin përkatës në mënyrë të përmbledhur i cili mund të rishqyrtohet nga komisioni këshillimor

Neni 11 **Komisioni këshillimor**

1. Komisioni këshillimor përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, ku 3 (tre) anëtarë janë punonjës nën varësinë e institucionit përgjegjës për dhënien e titullit dhe 2 (dy) anëtarë janë personalitete të jashtme.
2. Institucioni përgjegjës për dhënien e titullit i dërgon Komisionit Këshillimor për shqyrtim të gjitha nismat për nderim, të bëra kryesisht ose nga institucionet që kanë të drejtë të ushtrojnë të drejtën e propozimit.

Neni 12 **Shqyrtimi paraprak i propozimit**



1. Sekretaria e Këshillit të Bashkisë propozimin për titullin vendor të nderit brenda 5 ditëve kalendarike ja përcjell për shqyrtim Komisionit Këshillimor për Titujt Vendor të Nderit.
2. Komisioni Këshillimor për dhënien e titujve vendor të nderit në Bashkinë Pogradec verifikon nëse akti i propozimit përmban të gjitha elementët e procedurës dhe dokumentet shoqëruese.
3. Në përfundim të verifikimit paraprak, Komisioni Këshillimor:
 - a) vendos për vijimin e shqyrtimit të nismës ose të propozimit;
 - b) i kërkon propozuesit që ka ndërmarrë nismën kryesisht ose institucionit propozues plotësimin e të metave të propozimit për nderim.
 - c) dërgon pranë institucionit përgjegjës për dhënien e titullit mendimin për mospranimin e propozimit kur ai është paraqitur jashtë afatit të përcaktuar.

Neni 13


Shqyrtimi i propozimit

1. Komisioni këshillimor brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e vendimit për vijimin e shqyrtimit të propozimit ose nga plotësimi i të metave të tij, shqyrton dhe dërgon mendimin për përmbushjen ose jo të kriterëve për nderim.
2. Krahas informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur në nismën ose propozimin për nderim, Komisioni kërkon informacione ose dokumentacion shtesë nga shtetasi i propozuar për nderim, si dhe nga çdo person fizik ose juridik apo organ publik, vendas ose i huaj, që disponon të dhëna të vlefshme për shqyrtimin e plotë të nismës ose të propozimit.
3. Në çdo rast, komisioni çmon, sipas bindjes së tij, se cilat fakte konsiderohen të provuara bazuar në parimet e përcaktuara në rregullore, në vlerësimin e hollësishëm të informacioneve dhe dokumentacioneve në dispozicion, si dhe në rezultatin tërësor të shqyrtimit, duke hartuar për këtë qëllim raportin përkatës.
4. Procesi i shqyrtimit të nismës ose propozimit mund të shtyhet për shkak të rrethanave të paparashikuara, që dëmtojnë reputacionin dhe vlerën e aktit të nderimit në opinionin publik, deri në sqarimin e këtyre rrethanave.

Neni 14

Mendimi i komisionit

1. Në përfundim të shqyrtimit, komisioni i dërgon institucionit përgjegjës për dhënien e titullit mendimin e arsyetuar për:
 - a) miratimin e nismës ose propozimit;
 - b) refuzimin e nismës ose propozimit për shkak të mosplotësimit të të metave brenda afatit kohor ose për shkak të mospërmbushjes së kriterëve sipas këtij ligji.



Neni 15

Vendimmarrja për propozimin

Miratimi ose refuzimi i propozimit bëhet me:

1. Vendim të Këshilli Bashkiak i cili është autoriteti përgjegjës për miratimin ose jo të propozimit për dhënien e titullit të nderit.
2. Votimi për dhënien e titujve të nderit mund të bëhet i fshehtë sipas përcaktimeve Ligjore
3. Në çdo rast vendimmarrja për propozimin u njoftohet institucionit propozues dhe komisionit këshillimor.
4. I njëjti propozim nuk mund të bëhet pa kaluar 2 (dy) vjet nga njoftimi për refuzimin e tij.

Neni 16

Heqja e titujve

Heqja e titujve dhe titujve vendorë të nderit bëhet:

1. me vendim të formës së prerë të dhënë nga gjykatat shqiptare, kur është dhënë si dënim plotësues sipas përcaktimeve në Kodin Penal;
2. me vendim të institucionit përgjegjës për dhënien e titullit vendor të nderit kur mbajtësi i tij:
 - a) është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
 - b) është shpallur “person i padëshiruar” sipas përcaktimeve të legjislationit që rregullon regjimin e hyrjes e të qëndrimit të të huajve në Republikën e Shqipërisë.

Neni 17

Çertifikata e akordimit të titullit

1. Çertifikata për akordim titujve është e formatit A4 dhe shoqërohet me simbolet e qytetit.
2. Çertifikatat për titujt e aprovuar nga Këshilli Bashkiak nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak dhe vulozet me vulën e Bashkisë Pogradec .
3. Çertifikatat për titujt e aprovuar nga Kryetari i Bashkisë nënshkruhet nga Kryetari dhe vulozet me vulën e Bashkisë Pogradec .

Neni 18

Ceremonia e dhënies së titullit

1. Ceremonia e dhënies së titullit organizohet nga institucioni propozues në bashkëpunim me sekretarinë e Këshillit Bashkiak.
2. Dhënia e titullit bëhet me ceremoni publike / jopublike.
3. Titujt e nderit e jep kryetari i Këshillit Bashkiak ose persona të autorizuar nga ai si dhe Kryetari i Bashkisë (për titujt e aprovuar prej tij)
4. Titulli i nderit i jepet personit të cilit i akordohet. Në rast dhënie titulli pas vdekjes, titulli i jepet familjareve të personit.

5. Si rregull , dhënia e titulli duhet të jetë e lidhur me përvjetorë e ngjarje të rëndësishme historike , kulturore si dhe me festat kombëtare.

Neni 19
Evidentimi i titujve te nderit

1. Të gjithë titujt që jepen nga Keshilli Bashkiak evidentohen në një regjistër të vecantë, i cili administrohet nga sekretaria e Këshillit Bashkiak.

Neni 20
Hyrja ne fuqi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi mbas aprovimit nga Këshilli Bashkiak

K R Y E T A R

Ilir XHAKOLLI